

KËRKIME ETNOLINGUISTIKE TE EMRAT VETJAKË NË KRAHINËN E DEVOLLIT ETHNOLINGUISTIC RESEARCH THROUGH ANTRONIMIES AT DEVOLL'S REGION

ANYLA SARAÇI

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë, Universiteti "Fan S. Noli", Bulevardi "Gjergj Kastrioti", Korçë
Email: animaxhe@yahoo.com

Përmbledhje

Emrat vetjakë dhe dukuritë që lidhen me to si zbulimet, dyemërsia, nofkat, janë një burim i mirë për kërkime etnolinguistike. Ato, nëpërmjet formave që paraqesin, ndryshimeve që pësojnë, dukurive gjuhësore që lidhen me format dhe trajtat gramatikore të tyre, në varësi të krahinës ku përdoren, nga kush përdoren, në çfarë situatash, krijojnë mundësi për të shqyrtuar dukuri që lidhen ngushtë me të folmen e një krahine. Krahina e Devollit, si një zonë e spikatur dialektore, ka një korpus të veçantë të emrave vetjakë që dallohen lehtësisht në gjithë korpusin e emrave vetjakë shqiptarë. Janë karakteristike zbulimet e emrave me prapashtesat –kë, -çkë (Kristaq-Kiçkë), nofkat, shndërrimet fonetike (Jorgo-Xhoxhi), dyemërsia për shkak të besimit (dukuri mjaft e zhvilluar pas viteve '90 të shekullit të kaluar). Të gjitha këto ofrojnë mundësi për hulumtime për të nxjerrë në pah karakteristikat e të folmes së kësaj krahine si dhe marrëdhëniet e saj me gjuhën standarde apo dhe me gjuhët e tjera Ballkanike.

Fjalë çelës: zbulim, nofkë, shndërrime fonetike, taktikë ligjërimi, prapashtesa zvogëluese.

Abstract

Proper names and similar linguistic phenomena, such as: cajolery, binomity and nicknames, provide a never exhausted source of ethno-linguistic research. They enable linguists to investigate the phenomena related with the local speech of a given area, through their forms, the area in which they are used, the person they are used by and the situation they are used in. Devoll, as a typical dialectal area, has a special corpus of proper names, easily distinguished in the Albanian corpus of proper names. Among others, this is reflected in cajolery of names by adding the endings –kë, -çkë (Kristaq, Kiçkë), nicknames, phonetics

transformations (Jorgo-Xhoxhi), binomity to reflect religious faith (a widespread phenomenon of the period after the years '90 of the last century). These offer a good source of research to reveal special characteristics of the local speech as well as the relation it builds with the standard speech or the other Balcan languages.

Key words: cajolery, nickname, phonetic transformations, discourse means, cajolery endin Hyrje

Antroponimia paraqet një interes të madh për albanologjinë në përgjithësi dhe për gjuhësinë në veçanti. Emri, si dukuri etnokulturore, paraqitet në forma dhe kuptime të ndërlikuara. Ai, bashkë me toponiminë, mbart në vetveten më shumë se përfaqësimin e një njeriu të veçantë. Siç thekson dhe Mark Krasniqi: "...mund të themi se emrat deri diku luajnë rolin e dokumentave historike, në bazë të të cilave mund të konstatohen ecuritë shoqërore e kulturore të një vendi". (1979, fq.100).

Në periudha të ndryshme, emrat vetjakë japin dëshmi të qarta të jetës ekonomike, shoqërore e kulturore të një vendi të caktuar. Por, më shumë gjurmë kanë lënë në ato shoqëri ku jeta patriarkale ka rrënjësuar thellë në ndërgjegjen e bashkësisë besimin se emri i njeriut nuk e identifikon atë vetëm nga pikëpamja fizike. Në këto shoqëri, emri ka përfaqësuar një identitet shpirtëror që lidhet ngushtë me besimin fetar, me mënyrën e jetesës, me klasën shoqërore, me ndikimin e besëtytnive në periudha të caktuara.

Emri, në traditën e popullit tonë, është i lidhur ngushtë me këto dukuri. Gjuhëtari ynë i madh E. Çabej ka vënë në dukje se: « *Emrat vetjakë, duke përfshirë aty emrat e viseve e të njerëzve, si një pjesë të thuash e pashkruar e leksikut të gjuhës, janë caktuar të zëvendësojnë deri diku dokumentet e shkrimit, që*

mungojnë kryekrejet për kohën para shekullit XV » (1982, fq. 43). Sot, në kohën e lëvizjeve të mëdha demografike, të globalizimit të ekonomisë dhe jetës shoqërore në tërësi, është gjithmonë e më i pranishëm rreziku i zhdukjes së këtyre dëshmimeve në rrjedhën e viteve. Trysnia e fuqishme e zhvillimit të teknologjive të informacionit, ndryshimet e mëdha të mendësive lokale, kombëtare e rajonale, politikave shtetërore të mëparshme dhe ato të sotme ndikojnë po aq fuqishëm dhe në globalizimin e emrave vetjakë.

Krahina e Devollit paraqet një interes të veçantë në këtë fushë. Duke u nisur nga pozita gjeografike krahina e Devollit ka një pozicion të rëndësishëm kufitar. Shumë fshatra, si Vërniku, Vidohova, Kapshtica, ndodhen në vijën kufitare me Greqinë. Kjo afërsi ka sjellë marrëdhënie të zhvilluara ekonomike, tregtare, midis fshatrave dhe qyteteve në të dyja anët e kufirit. Rrjedhimisht, në popullsitë e këtyre zonave, vihen re dhe ndikime të dyanshme kulturore, gjuhësore e zakonore.

Një faktor i rëndësishëm, me ndikim mjaft të madh në antroponiminë e kësaj zone është besimi fetar. Në këtë krahinë ka pasur fshatra vetëm me popullsi të krishterë ortodoksë (kryesisht në Devollin e Sipërm), si dhe fshatra me popullsi të përzier, ortodoksë dhe myslimanë.

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX si dhe fillimin e shekullit XX në këtë krahinë kemi lëvizje të mëdha migratore, si në Ballkan (kryesisht në Greqi, Rumani e Bullgari), ashtu dhe në vende të largëta, kryesisht në SHBA dhe Australi. Kryesisht, kurbeti u përhap si dukuri në fshatrat e Devollit të Sipërm (Bradvicë, Dardhë, Sinicë, Qytezë), të cilat kishin pak tokë, si rrjedhim më pak mundësi ekonomike. Këto lëvizje sollën me vete zakone të reja, përzierje mendësish, kulturash, si dhe ndikuan dhe në antroponiminë e kësaj krahine.

Njëkohësisht, ndikim në antroponiminë e zonës kanë pasur besimet popullore dhe bestytnitë si dhe faktori historik. Krahina e Devollit ka njohur kthimet e detyruara të fesë dhe njëkohësisht të emrave në periudha të ndryshme historike, dukuri që vazhdon dhe në ditët e sotme.

Nëse bëjmë një paraqitje të shkurtër etnolinguistike të antroponimisë së Devollit do të dallonim:

Emrat kalendarikë fetarë

Këta emra janë të pranishëm në të dy besimet, të krishterë dhe myslimanë. **Emrat e besimit të krishterë** janë gjerësisht të përhapur në të gjithë krahinën. Kryesisht, këta emra ngushtohen në sferën e emrave që vijnë nga shenjtoret. Kjo dukuri është kryesisht e përhapur në të gjithë fshatrat që kanë banorë të besimit ortodoks.

Së pari, duhen përmendur emrat teofanë të cilët kanë të bëjnë me riprodhimin e emrit të Krishtit, Marisë, nënës së tij si dhe të zotit si emër të përveçëm. Duhet vënë në dukje se te emrat e vjetër (të brezave para viteve '60) gjenden disa variante të njëjtit emër. Emri i Krishtit gjendet në formën *Kristaq*, me variantet e shkurtuara *Kiço*, *Taqo*, *Kici* (ky i fundit si rrjedhim i ndikimit të «baby-talk»). Në variantin femëror gjenden *Kristina*, *Krisulla*. Përsa i përket emrit *Maria*, varianti themelor në Devoll ka qënë *Marika* si një ndikim i greqishtes, ndërsa sot po përhapet gjithmonë e më tepër *Maria* si rrjedhim i rikthimit të praktikës fetare të pagëzimit, por nuk mungon dhe varianti *Marina*. Një emër që gjendet në këtë zonë është dhe *Theofan* me variantin e shkurtuar *Fani*. Sipas M. Krasniqit ky emër i përket periudhës parakristiane (1979, fq 111). Po ashtu gjendet dhe *Theodor-Theodhora-Dhorothea*. Variantet e sotme gjenden me prapashtesën –*ela Dhorjela* apo me shndërrimin e *th:t* dhe *dh:d* *Teodor-Teodora-Dorotea*, rrjedhim i ndikimit të gjuhëve perëndimore. Mjaft të përhapur janë emrat e shenjtoreve dhe apostujve të Krishtit. Në breznitë deri në vitet '60 te këta emra vihen re përshtatje fonetike sipas ligjësive të shqipes.

Këtu mund të përmendim emrin *Jovan* dhe *Jani*. Varianti i parë del me shkurtime *Vani*, *Vançi*, mund të besohet se është më i hershëm, i përket ndikimeve sllave, mjaft të dukshme në këtë zonë. Ndërsa varianti i dytë, herë del si shkurtime i emrit *Jovan* (p.sh në Hoçisht), por më tepër del si emër më vete. Nëse i referohemi Gj. Shkurtaç (2005, fq. 299) ky variant i përket një shtrese të besimit ortodoks më të hershëm të shtrirë përgjatë Toskërisë Veriore, si ndikim i drejtpërdrejtë nga greqishtja. Varianti *Joan* del më tepër si variant i modernizuar, por pa glotalen *h*, e cila mungon në të folmen e Devollit

Emri *Gjergji* ndeshet më shumë në brezat pas viteve '60. Në format e vjetra ai vjen me variantet *Jorgo*, *Jorgaq*, *Jorgji* (me theks parafundor), ndërsa në variantin femëror *Jorgji-Jorgjia* (me theks fundor) dhe në një variant më modern *Jorgjeta*. Ky emër paraqet larmi zbulimesh që mund të vijnë për shkaqe të ndryshme. Një prej tyre, mjaft i përhapur është *Xhoxhi*, mund të mendohet se ky zbulim mund të këtë ardhur si rrjedhim i ndikimit të folurit femëror. Ndërkohë gjejmë dhe formën *Jorgaq* (*Gaqo-Gaqi-Gaqkë*, dukuri e zakonshme e zbulimit në krahinën e Devollit, kryesisht për të shmangur emrine gjatë, por dhe për të shprehur nuanca emocionale të të caktuara).

Ndikimet nga greqishtja gjenden në variantet e emrave *Nikollë-Nikollaç*, *Vasil-Vasillaç*. Për emrin *Nikollaç* në kohët e sotme gjendet kryesisht varianti *Nikolin*, me

zbunimet *Niko-Koli* dhe *Vaskë-Cile*. Në ndryshim nga emërtimi i shenjtit dhe të kishave përkatëse që paraqiten me formën e vjetër Shën Koll, në emrat vetjakë hasim vetëm trajtat ku kemi kalim *ll:l*. Kjo gjë ka ndodhur dhe me emrin *Ilija-Ilo*, në format e reja *Ilir, Ilirjan*, ku emri i shenjtit paraqitet *Shëndëlli-Shëndëllia* (ndodhen sot e kësaj dite toponime të kësaj forme atje ku ka pasur kishë apo manastir kushtuar këtij shenjti, p.sh.kodra e Shëndëllisë në Hoçisht, fshati Shënkoll-Fitore), ndërsa në variantet femërore më të përhapura janë *Nikoleta, Vasilika*. E para është dukuri pas viteve '60, ndërsa *Vasilika* është formë e huazuar nga greqishtja dhe gjendet hershëm në këtë krahinë.

Emri *Pavullo – Pavlina* dallojnë në variantet e shkurtuara nga mbaresa e gjinisë *Pali-Pala*. Ndërkohë që shkurtimi mashkullor përdoret vetëm në trajtën e shquar (në ndryshim nga përdorimet e këtij emri në gegërisht), shkurtimi i emrit femëror përdoret rëndom në të dy trajtat *Palë-Pala*.

Përgjithësisht, këta emra i përkasin arealit të dytë të që përfshin emra të shtrirë përgjatë Toskërisë Veriore dhe Jugore ku ndikimet nga gjuhët fqinje janë më të dukshme. Këto ndikim duken, jo thjesht në huazimin e formave fonetike, por dhe në mjetet gramatikore të formimit të këtyre emrave. Kështu mund të përmendim prapashtesat greke *-aq*, për gjininë mashkullore (*Petraaq, Kristaaq, Nikollaq, Vasillaq*) dhe *-ulla* për gjininë femërore (*Krisulla, Athinulla*)

Në këtë krahinë, sipas rritit ortodoks, fëmija pagëzohej ditën e të tretave dhe emrin nuk zgjidhej nga familjarët, por kumbara i fëmijës. Përgjithësisht ai ishte pjesëtar i një familjeje që kishte kumbarinë e shtëpisë, kështu në të njëjtën familje kumbaria shkonte brez pas brezi. Kumbarja i familjes e përzgjidhte emrin në varësi të disa faktorëve:

1- Në varësi të afërsisë së ditës së lindjes me ditën shënuar të një festë fetare.

2- Në shumicën e rasteve nga emrat e familjarëve të vdekur (kryesisht të gjyshërve dhe më pas të një të afërmi që mund të kishin vdekur në moshë të re).

3- Që para viteve '60 vihet re përzgjedhja e dy emrave, njëri me shenjt dhe tjetri për përdorim të përditshëm, varej nga familjarët se cili emër mernte përparësi (nga kërkimet një fëmijë i lindur në vitet 30 u pagëzua me emrin *Vasil*, por iu vu dhe emri *Napolon*, shkurt *Poleç*)

Emri, në traditën e krahinës, ishte aq i rëndësishëm sa festohej në një ditë të caktuar sipas kalendarit fetar të besimit ortodoks. Në këtë ditë, familjarët e atij që kishte emrin çonin në kishë një meshë, këtë gjë e bënin gratë e shtëpisë. Ato "*shkonin të ngrinin psomën*", ku psomë quhej mesha që çohej në kishë dhe vjen nga greqishtja. Në shtëpi bëheshin vizita dhe i urohej "*ta gëzojë emrin për shumë vjet*". Ditëlindjet, në

shumë raste harroheshin, por dita e emrit asnjëherë. Pavarësisht se dhe emrat e femrave përkonin me ditët e shenjta, atyre nuk u festohej dita e emrit. Krentimi i ditës së emrit ishte privilegj vetëm i meshkujve të familjes, pavarësisht nga mosha e tyre.

Emrat e besimit islam

Këta emra i përkasin një areali më të gjerë se të parët. Janë emra të një periudhe të mëvonshme (rreth shekujve XV-XVI). Për nga forma fonetike përgjithësisht këta emra paraqiten në të njëjtën formë në të gjitha krahinat e Shqipërisë. Hasim emrat *Ali, Bajram, Novruz, Rexhep, Muamet* që lidhen kryesisht me emra dhe festa fetare të rritit mysliman. Veçoria kryesore e këtyre emrave është mungesa e plotë e glotales *h* tek emrat që e kanë këtë bashkëtingëllore në trup të fjalës (*Memet, Muamet*). Por, hasen dhe forma të emrave të përbërë të tipit, *Memetali, Muaremalij, Bajramali*. Përgjithësisht, këta emra viheshin nga klerikë myslimanë, po nuk mungojnë rastet kur merreshin parasysht ëndrrat dhe dëshirat e njerëzve më të moshuar të familjes, qoftë femra, qoftë meshkuj. Dhe te banorët e këtij besimi është e pranishme dukuria e dyemërsisë, "emrit në kërtëzë" që lidhej me besimin dhe emrit që përdorej nga preferencat e familjarëve.

Emrat jofetarë

Emrat jofetarë janë mjaft të përhapur dhe përmbledhin një numër të madh emrash të vjetër e të rinj:

1. **shtresën e vjetër të emrave që lidhen kryesisht me paqanizmin.** Lidhen kryesisht me perëndi greke (*Persefoni, Dhimitra*), me kultin e hënës (*Hëna, Perihëna*),

2. **shtresën e emrave që lidhen me botën bimore.** Janë kryesisht femrash, *Manushaqe, Shega, Lule, Nerënxa, Vjollca;*

3. **shtresa e emrave që lidhen me botën e kafshëve,** *Pëllumb-Pëllumbesha, Luan, Mirdash (Dash);*

4. **shtresa e emrave që lidhen me besëtytni të caktuara.** Në krahinën e Devollit, emri është parë si një element ku mëshirohen disa nga veçoritë fizike dhe shpirtërore të bartësit të tij. Ai konsiderohej si një lloj mbrojtësi për shëndetin e fëmijëve. Për meshkujt është mjaft i përhapur emri *Guri*. Të krishterët e përdornin vetëm në këtë variant dhe vetëm për meshkujt, ndërsa te myslimanët gjendet me variantet me prapashtesë si për gjininë mashkullore dhe për atë femërore, *Gurazi-Guraze dhe Gurtali*. Ky emër u vihej fëmijëve me shëndet të dobët ose në familjet ku kishin vdekur shumë fëmijë. Po në familjet myslimane përdorej rëndom dhe emrin *Hekuran*, si një formim prapashtesor nga fjala *hekur* për të njëjtën arsye. Megjithatë, ka dhe forma të përbëra ku njëra temë është jofetare dhe tjetra jofetare (*Guradem, Gurtali*)

5. ***shtresa e re e emrave nga të periudhës '60-'90.*** Në këtë periudhë u përhapën emra si *Agim, Agron, Alban, Dëfrim, Bekim, Shpresa, Zana, Afërdita, Anila, Dritan*, që ofroheshin nga gjendjet civile si emra shqiptarë. Bien në sy një mori emrash që vijnë nga emra foljorë veprimi me prapashtesën *-im*, ndikimi i drejtpërdrejtë i gjuhës së shkruar. Krahas tyre paraqiten një sërë emrash të frymëzuar nga letërsia artististike. Në raport me toponiminë e fshatrave kjo dukuri u përvetua më lehtë. Ndërkohë që emrat e fshatrave, që u ndryshuan me ligje dhe vendime shtetërore në tabela dhe dokumente zyrtare, nuk mundën të zhdukeshin nga kujtesa kolektive bashkësisë gjuhësore, te emrat vetjakë ndodhi shumë më lehtë. Ndoshta, kjo gjë u lehtësua nga fakti që në këtë kohë u bënë përpjekje të mëdha për zhdukjen e besimit fetar. Por dhe vetë njerëzit, në këtë periudhë, i shihnin emrat fetarë si me tingëllim të vjetruar dhe të papërshtatshëm për fëmijë të vegjël. Në njëfarë mënyre, vendosja e këtyre emrave u bë me detyrim, por në shumë raste fëmijëve u viheshin dy emra, një zyrtar dhe një fetar.

Po cilat janë kahet e sotme të antroponimisë në Devoll?

Së pari është ringjallur tradita e ripërtëritjes së emrit të gjyshërve të familjes, por tani u vihet emri dhe kur ata janë gjallë. Kjo ripërtëritje bëhen me tri mënyra. E para vihet emri i njëjtë me atë të bartësit të mëparshëm, së dyti vendoset emër më i përshtatur me kohët e sotme (*Kistaq-Kristi, Krisulla-Krisela-Kristela, Theodor-a-, Dhorothea-Teodor-a-Tea-Dorotea, Thoma-Tomi*), së treti me vendosje emrash sipas vendeve ku kanë emigruar, kryesisht emra grekë (*Engjiliqi. Gliqiri*).

Ndikimi i botës së aktorëve, këngëtarëve, spektaklit, telenovelave dhe sportit është aq e fuqishme sa në morine e emrave të sotëm të vështirë të dallos në cilin kontinent jeton. Në një pjesë të madhe mbiemrat e njerëzve të shquar janë bërë emra vetjakë (*Klinton, Alkeo*).

Po vihet re që po përhapen mjaft emrat fetarë ortodoksë dhe te banorët myslimanë. Kjo ka ndodhur dhe ndodh në shumicën e familjeve që jetojnë në Greqi dhe që për arsye të ndryshme ndërrojnë dhe fenë.

Pra, mund të thuhet se antroponimia, sot, është bërë një dukuri dhe më e ndërlikuar se më parë. Është e vështirë të zbulohen rrënjët e emrave të sotëm, të cilët siç e thekson dhe prof. Gj. Shkurtaç "*...ashtu siç ka qenë dhe vijon të jetë Shqipëria si vend dhe si komb, midis Perëndimit dhe Lindjes, ashtu dhe emrat vetjakë të shqiptarëve (si pjesë e gjuhës dhe kulturës sonë kombëtare) ka mbetur kurdoherë ndërmjet dy-tri forcash magnetike*", përkatësisht *perëndimore dhe lindore*" (2005, fq. 301).

Fakti që shqiptarët tashmë nuk jetojnë më në një shoqëri të izoluar, por janë të hapur si në lëvizje dhe në mendësi po sjell gjithmonë e më tepër zbehjen deri në zhdukje të dëshmimeve etnokulturore që vijnë nëpërmjet antroponimisë. Prandaj, është detyrimisht e domosdoshme të hulumtohen materiale nga të gjitha krahinat shqiptare, sidomos në Jug, për një studim të thelluar të izoglosave të antroponimisë në dritën e izoergjeve kulturore e shoqërore që veprojnë mbi to.

Bibliografia

- ÇABEJ, E. (1982) *Studime etimologjikenë fushë të shqipes 1*, Tiranë
 KRASNIQI, M. (1979), *Gjurmë dhe gjurmime*, SHB "8 Nëntori", Tiranë
 SHKURTAJ, GJ. (2001), *Onomastikë dhe etnolingistikë*, SHBLU, Tiranë
 SHKURTAJ, GJ. (2005), *Sociolingvistika*, SHB "Toena", Tiranë
 SHKURTAJ, GJ. (2004), *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHBLU, Tiranë